



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje



Nr i Protokolit 010

19.01.2022

Rahovec

-IV- Nr. i prot. 010 Më Dt. 19.01.2022  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 68 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtaret Publik ,Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5,paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

## Konkurs

Për plotësimin e 1 pozite të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2021/2022:  
Mësimdhënës/e për Lëndën e Historisë, në SHFMU-të e Komunës së Rahovecit.

### Kushtet për konkurim:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.05/2021, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

### Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

### Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

### Lista Pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 59 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë-Mësimdhënës/e për Lëndën e Historisë, kanë të drejtë të punësohen.

### Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

### Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 21.02.2022 dhe zgjat 15 ditë kalendarike dhe atë deri me datë 07.03.2022, deri në ora 16<sup>00</sup>.

Rahovec,  
19.01.2022



Avni Morina,Drejtor

*Avni Morina*